



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 12, datë 17.07.2020

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT DEDË KASNECI NË VENDIN VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018 DHE RISHPALLUR NË DATËN 27.09.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Fiona Papajorgji	- Anëtare
Arta Marku	- Anëtare/Relatore
Miranda Andoni	- Anëtare
Saida Dollani	- Anëtare
Ludovik Dodaj	- Anëtar
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Arjan Qafa	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësues i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **znj. Katrin Treska**, përfaqësuese e autorizuar e Presidentit të Republikës,

- **në mungesë të përfaqësuesve të tjerë të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje,**

në mbledhjen e datës 17.07.2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR GJYQATAR
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

z. Dedë Kasneci

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të z. Dedë Kasneci, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **Arta Marku**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurës së verifikimit dhe të vlerësimit, për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, me vendimin nr. 137, datë 21.09.2019, vendosi:

- Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me dekretin nr.10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

3. Në zbatim të vendimit nr. 137, datë 21.09.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, Presidenti i Republikës, në datën 27.09.2019, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

4. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

5. Në vijim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr.138 datë 22.10.2019, vendosi:

Revokimin e vendimit nr. 137, datë 21.09.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723, datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës”.

Vijimin e procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit, të kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të rishpallur me Dekretin nr.11291 datë 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.”

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar në datën 05.04.2019, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016) dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit, z. Eriol Roshi. Për shkak të përfundimit të mandatit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) 2019, zhvillimi i procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant i kaloi Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020, i cili në datë 15.01.2020 zhvilloi shortin manual dhe relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit Arta Marku. Sipas parashikimit të pikës 5/2, shkronja “b”, të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, relatorja kontrolloi saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera dhe konfirmoi veprimet e kryera nga relatorët e mëparshëm.

7. Z. Dedë Kasneci, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për t’u paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Dedë Kasneci, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 25.10.2019, kandidati Dedë Kasneci është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit i deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

9. Në datën 30.10.2019, kandidati Dedë Kasneci ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke qenë se për kandidatin, z. Dedë Kasneci, ka vijuar procedura e verifikimit paraprakisht, pasi ka aplikuar edhe për pozicionin vakant të shpallur nga Kuvendi, nuk ka dërguar shkresa dhe nuk ka kërkuar informacione shtesë. Verifikimi i këtij kandidati do të bëhet me dokumentacionin e kërkuar më parë për pozicionin vakant të shpallur nga Kuvendi, pasi nuk ka hapësirë kohore ndërmjet tyre dhe nuk do të mbingarkohej procesi i verifikimit me shkresa të përsëritura për të njëjtin kandidat. Përgjashtimisht nga ky rregull, është korrespondenca me ILDKPKI-në, për të cilën janë dërguar shkresat sipas parashikimeve ligjore.

11. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 703 prot., datë 30.10.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 8577/2000 dhe ligjit nr. 115/2016.

12. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe deklarata e nënshkruar nga kandidati Dedë Kasneci, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës së tij.

13. Me shkresën nr. 4340/1 prot., datë 03.12.2019, ILDKPKI-ja ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Dedë Kasneci e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

14. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367/2005), me shkresën 4340/1 prot., datë 03.12.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci dhe personat e lidhur me të.

15. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Dedë Kasneci dhe personave të lidhur me të.

16. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Dedë Kasneci, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 09.10.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka Societe Generale, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union;
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit

Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë;

c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal;

ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

17. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 16 më sipër, me përjashtim të Banka Alpha Albania, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Dedë Kasneci.

18. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 603 prot., datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Dedë Kasneci sipas ligjit nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*” (në vijim ligji nr. 138/2015).

19. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2690/117 prot., datë 03.12.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci.

20. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatis Dedë Kasneci, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr.602 prot., datë 09.10.2019) dhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr.604 prot., datë 09.10.2019).

21. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr. 3776 prot., datë 21.11.2019, si dhe nr. 2155 prot., datë 22.10.2019.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015 “*Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*” (në vijim ligji nr. 45/2015), si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet*

vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 601 prot., datë 09.10.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Dedë Kasneci për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1386/4 prot., datë 25.10.2019, ka dërguar Vendimin nr. 671, datë 25.10.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 e 93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Dedë Kasneci në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 16.10.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Dedë Kasneci.

26. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, rezulton se kandidati Dedë Kasneci ka ushtruar veprimtari profesionale si vijon:

- a) Lektor i lëndëve “E drejta e Agrare” dhe “E Drejta Administrative” për periudhën shkurt 1999 - mars 2000 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
- b) Inspektor Jurist në Institucionin e Prefektit Qarku Shkodër, 12 mars 2001-maj 2002.
- c) Lektor i lëndës “E Drejta Institucionale e Bashkimit European” Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti “Gjon Buzuku” Shkodër, vitet akademike 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014.
- d) Këshilltar ligjor në shërbimin e përafrimit të legjislacionit pranë Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 16 prill 2007 – 12 prill 2010.
- e) Drejtor i shërbimit për përafrimin e legjislacionit pranë Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 12 prill 2010 e në vazhdim.

27. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me e-maillet e datave 05.11.2019 dhe 08.11.2019, i ka kërkuar kandidatit të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente justifikuese shtesë lidhur me konkluzionet e ILDKPKI-së dhe lidhur me eksperiencën e tij të punës, nëse e konsideron në përputhje me *nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”*. Kandidati Dedë Kasneci ka paraqitur shpjegimet e tij dhe dokumentet justifikuese nëpërmjet postës elektronike, përkatësisht në datë 12.11.2019 dhe në datë 13.11.2019.

28. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikës 95 dhe 96 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

29. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2020, ora 13 e 30, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt verifikimin e kandidaturës së z. Dedë Kasneci, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019.

30. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Dedë Kasneci, nëpërmjet postës elektronike zyrtare, në datën 13.07.2020.

31. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

32. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2020, ora 13 e 30, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

33. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

34. Në mbledhjen e Këshillit, pas relativitetit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Dedë Kasneci.

35. Avokati i Popullit parashtrroi se ishte dakord në thelb me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe ka sugjeruar disa elemente shtesë që duhet të përmbajë në të ardhmen relacioni në lidhje me përcaktimin e kohës së veprimeve (të përfundimit të hetimit prej relatorit apo të komunikimit të gjetjeve kandidatit). Po ashtu, sugjeroi që në drejtim të verifikimit të kriterit ndalues që lidhet me pasjen e pozicioneve drejtuese në parti politike të komunikohet në të ardhmen edhe me KQZ-në.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

36. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2690/117 prot., datë 03.12.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci, duke ardhur në përfundimet se:

Subjekti deklaruës Dedë Kasneci, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

37. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.1386/4 prot., datë 25.10.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vendimin nr. 671, datë 25.10.2019, me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci, duke ardhur në përfundimet se:

Për zotin Dedë Kasneci, nga verifikimet e kryera deri tani, nuk figuron të ketë materiale në dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tij, sipas nenit 29, pika 2 të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

38. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. 2155 prot., datë 22.10.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituar në pikën më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Dedë Kasneci:

Nuk figuron i evidentuar për veprimtari kriminale.

39. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 3776 prot., datë 21.11.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara në pikën më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Dedë Kasneci:

Në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 gërmat "a" dhe "c" për integritetin e figurës së z. Dedë Kasneci.

40. Nisur nga rezultatet si më sipër, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Dedë Kasneci, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, **nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.**

41. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave "b", "c" dhe "d" të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Dedë Kasneci në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të tij.

42. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "b" e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Dedë Kasneci ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1998 si jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të

Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë **kandidati Dedë Kasneci nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.**

43. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidati Dedë Kasneci nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë **kandidati Dedë Kasneci nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.**

44. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, sikurse rezulton nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidati Dedë Kasneci nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit). Për rrjedhojë **kandidati Dedë Kasneci nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.**

45. Në lidhje me kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati Dedë Kasneci nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që ajo të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë **kandidati Dedë Kasneci nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.**

46. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatët *të kenë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Dedë Kasneci ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Lektor i lëndëve “E drejta e Agrare” dhe “E Drejta Administrative” për periudhën shkurt 1999 - mars 2000 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër;
- b) Inspektor Jurist në Institucionin e Prefektit Qarku Shkodër, 12 mars 2001- maj 2003;
- c) Lektor i lëndës “E Drejta Institucionale e Bashkimit European” Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti “Gjon Buzuku” Shkodër, vitet akademike 2011 - 2012, 2012 - 2013, 2013 – 2014;
- d) Këshilltar ligjor në shërbimin e përafrimit të legjislacionit pranë Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 16 prill 2007 – 12 prill 2010;
- e) Drejtor i shërbimit për përafrimin e legjislacionit pranë Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 12 prill 2010 e në vazhdim.

\

47. Në komentet e paraqitura me shkrim nga kandidati Dedë Kasneci, me e-mailin e datës 13.11.2019, në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Këshilli nëse pozicionet e punës së deklaruara prej tij plotësojnë kërkesën e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, ai ka parashtuar si më poshtë:

"1. Komente të përgjithshme lidhur me vjetërsinë time në punë, për efekt të kandidimit tim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese

Referuar Jetëshkrimit tim si dhe dokumentacionit shoqërues (Libreza e Punës dhe Vërtetimet përkatëse) që unë kam dorëzuar për të vërtetuar plotësimin nga ana ime të kriterit ligjor lidhur me përvojën në punë, të përcaktuar në nenin 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000, për efekt të kandidimit tim si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, rezulton se periudhat e përvojës time në punë ose të vjetërsisë në profesion deri në datat e kandidimit tim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, (i.e deri në datat 16 shtator 2019 pranë Kuvendit dhe 18 tetor 2019 pranë Presidentit të Republikës) janë si vijon:

a) Lektor i lëndëve "E Drejta Agrare" dhe "E Drejta Administrative", për periudhën shkurt 1999 - mars 2000 (1 vit e 1 muaj), pranë Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Drejtësisë;

b) Inspektor Jurist për periudhën Mars 2001 - Prill 2003 (2 vite e 1 muaj), pranë Prefektit të Qarkut Shkodër;

c) Këshilltar ligjor në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit, për periudhën Prill 2007 - Prill 2010 (3 vite), pranë Kuvendit të Shqipërisë;

ç) Drejtor i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit, për periudhën prill 2010 edhe në vazhdim (i.e 9 vite e 5 muaj deri në datën 16 shtator 2019 dhe 9 vite e 6 muaj deri në datën 18 tetor 2019), pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

d) Lektor i lëndës "E drejta institucionale e Bashkimit Europian", për periudhën mars 2011 - korrik 2014 (3 vite e 4 muaj), pranë Universitetit "Gjon Buzuku", Shkodër, Fakulteti i Drejtësisë.

Në total, unë kam 18 vite e 11 muaj përvojë pune ose vjetërsi në profesion deri në datën 16 shtator 2019, kur kam kandiduar pranë Kuvendit dhe 18 vite e 12 muaj (ose 19 vite) përvojë pune ose vjetërsi në profesion deri në datën 18 tetor 2018, kur unë kam kandiduar pranë Presidentit të Republikës.

Neni 7/a, pika 2, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, parashikon se kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

"a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;"

Referuar përvojës time në punë deri në datat e kandidimit tim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, rezulton se unë plotësoj kriterin ligjor lidhur me përvojën në punë, të përcaktuar në nenin 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000.

- Nga 18 vite e 11 muaj përvojë pune që unë kam në total deri në datën e kandidimit pranë Kuvendit:

- 4 vite e 5 muaj janë përvoja pune si "lektor i së drejtës" në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000;

- 14 vite e 6 muaj si "jurist i nivelit të lartë në administratën publike", në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000;

- Nga 19 vite përvojë pune që unë kam në total deri në datën e kandidimit tim pranë Presidentit të Republikës:

- 4 vite e 5 muaj përvoja pune si "lektor i së drejtës" në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000;

- 14 vite dhe 7 muaj si "jurist i nivelit të lartë në administratën publike", në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

2. Komente specifike lidhur me statusin e çdo pozicioni pune të deklaruar nga ime, për efekt të kandidimit tim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

a) Komente lidhur me statusin e pozicionit të punës si lektor pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" për periudhën shkurt 1999 - mars 2000.

Gjatë periudhës shkurt 1999 - mars 2000 kam qenë as. pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës: konkretisht lektor i lëndëve "E Drejta Agrare" dhe "E Drejta Administrative". Në këtë pozicion jam pranuar me konkurs publik të shpallur nga Universiteti i Shkodrës në janar 1999.

Statusi i pozicionit tim të punës si as. pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës për periudhën shkurt 1999 - Mars 2000 barazohet plotësisht me statusin "lektor i së drejtës" në kuptim të nenit 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000.

-Detyrat funksionale që unë kam përmbushur si as. pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës për periudhën shkurt 1999 - mars 2000.

Si lektor i lëndëve "E Drejta Agrare" dhe "E Drejta Administrative" kam qenë përgjegjës për:

-Hartimin e programit të studimit të këtyre 2 lëndëve, sipas Rregulloreve të Brendshme të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës;

-Kryerjen e veprimtarisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në këto fusha të së drejtës;

-Përgatitjen e leksioneve, sipas programit të këtyre 2 lëndëve dhe prezantimin e tyre përpara studentëve (i.e lektor i parë);

-Zhvillimin e seminareve me studentët për këto 2 lëndë;

-Përgatitjen e tezave provimeve, zhvillimin e provimeve si dhe vlerësimin e studentëve për këto dy lëndë mësimore.

- Komente lidhur me statusin tim si as. pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës për periudhën shkurt 1999 - mars 2000 dhe a mundet që ky status të barazohet me atë të "lektorit" në kuptim të nenit 7/a, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 8577/2000.

Termi "lektor i së drejtës" i parashikuar në nenin 7/a, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr.8577/2000, i referohet termit "lektor" që përfshihet në kategoritë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë".

Kategoritë e personelit akademik, në institucionet e arsimit të lartë aktualisht janë të përcaktuara në nenin 59 të ligjit Nr. 80/2015, pika 2 e të cilit parashikon se:

"2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor.

Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:

a) profesorë;

b) lektorë;

c) asistent-lektorë."

Pika 4 e këtij neni parashikon se:

"Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar."

Duke marrë në konsideratë kërkesat e ligjit në fuqi në kohën që unë kam qenë as. pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës në periudhën shkurt 1999 -

Mars 2000 (ligji nr.8461, datë 25.2.1999) si dhe detyrat dhe përgjegjësitë që unë kam përmbushur në këtë pozicion, por edhe kriteret që ligji aktual për arsimin e lartë (ligji Nr. 80/2015) parashikon që anëtarët e personelit akademik duhet të plotësojnë për t'u përfshirë në kategorinë "lektor" (i.e të zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore; të mbajnë gradën shkencore "Doktor", të kenë tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade;) rezulton se statusi im si as. pedagog i jashtëm pranë këtij universiteti dhe gjatë kësaj periudhe barazohet plotësisht me statusin e "lektorit të së drejtës", në kuptimin e të nenit 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000.

b) Komente lidhur me statusin e pozicionit të punës time si inspektor jurist pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër për periudhën mars 2001 - prill 2003.

Gjatë periudhës nga data 12 mars 2001 deri në datën 30 prill 2003 kam qenë Inspektor Jurist në Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër (në Zyrën Juridike gjatë periudhës 12 mars 2001 - 15 maj 2002 dhe në Zyrën e Rendit gjatë periudhës 15 maj 2002 - 30 prill 2003). Në këtë pozicion jam pranuar me konkurs publik të shpallur nga ish-Prefekti i Shkodrës muajin janar 2001.

Pozicioni i punës si inspektor jurist pranë Prefektit të Qarkut Shkodër për periudhën mars 2001 - prill 2003, barazohet me atë të "juristit të nivelit të lartë në administratën publike", në kuptim të nenit 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000.

Misioni dhe detyrat funksionale që unë kam përmbushur si inspektor jurist pranë Prefektit të Qarkut Shkodër:

Neni 114 i Kushtetutës parashikon se: "Këshilli i Ministrave cakton prefektin si përfaqësues të tij në çdo qark". Gjithashtu ligji nr. 7608, date 22.9.1992 "Për prefekturat", ndryshuar me ligjin nr. 8209, date 22.4.1997 parashikonte se "Prefekti është përfaqësues i qeverisë në planin lokal". Përveç rolit të përfaqësuesit të qeverisë në qark, prefekti, sipas ligjit në fuqi në kohën kur unë kam ushtruar funksionin e inspektorit jurist pranë Prefekturës Shkodër, por edhe sipas ligjit në fuqi (ligji nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut") ka për mision edhe të kontrollojë ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit vendor si dhe të bashkërendojë veprimtarinë e shërbimeve të administratës shtetërore në njësitë administrative tokësore të vendit (neni 1 i ligjit nr.7608/ 1992 "Për prefekturat" dhe neni 8 i ligjit nr. 107/2016).

Në pozicionin e inspektorit jurist në Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër kam përmbushur detyrat e caktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 202, datë 26.03.1998 "Për detyrat e aparatit administrativ të Prefekturës" dhe detyrat e përcaktuara për inspektorin jurist në Rregulloren e Brendshme të Prefekturës Shkodër. Konkretisht në këtë pozicion kam përmbushur këto detyra:

-Mbështetja e Prefektit të Qarkut me asistencë ligjore lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore të Qarkut Shkodër (36 Komuna dhe Bashki),

-Ofrimi i asistencës ligjore për Prefektin e Qarkut Shkodër gjatë ushtrimit të funksionit të tij kontrollues dhe bashkërendues të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor (Drejtoritë Rajonale),

-Përfaqësimi ligjor i Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër në proceset gjyqësore, ku institucioni i Prefektit ishte palë,

-Hartimi i projekt - akteve të nxjerra nga Prefekti i Qarkut Shkodër (urdhra dhe udhëzime), në ushtrim të funksioneve të tij,

-Kordinimi i veprimtarisë së njërive të qeverisjes vendore të Qarkut Shkodër (ish-komuna, bashki dhe qark) për menaxhimin e emergjencave civile të ndodhura në këtë qark.

Komente lidhur me pozicionin e punës inspektor jurist pranë Prefektit të Qarkut dhe a mundet që ky pozicion pune të barazohet me atë të "juristit të nivelit të lartë në administratën publike", në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

Duke marrë në konsideratë misionin dhe rolin e Prefektit të Qarkut, i cili sipas Kushtetutës dhe ligjit në fuqi në kohën që unë kam ushtruar detyrën e inspektorit jurist në këtë institucion (ligji nr.7608/ 1992), ishte përfaqësues i Këshillit të Ministrave në Qark si dhe faktin se Prefekti me ligj ishte dhe është instancë e dytë administrative në kontrollin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga organet e pushtetit lokal në territorin e Qarkut si dhe detyrat funksionale që unë kam ushtruar si inspektor jurist pranë institucionit të Prefektit dhe në veçanti detyrën shume të rëndësishme funksionale lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së akteve (vendime, urdhëresa dhe rregullore) të nxjerra nga organet e pushteti lokal në territorin e Prefekturës së Qarkut Shkodër (36 komuna dhe bashki si dhe 3 rrethe), rezulton se pozicioni i punës inspektor jurist që unë kam ushtruar pranë institucionit të prefektit barazohet me atë të "juristit të nivelit të lartë në administratën publike", në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

Institucioni i Prefekti është një institucion kushtetues i parashikuar nga neni 114 i Kushtetutës i cili ka për mision të përfaqësojë Këshillin e Ministrave në qark. Për rrjedhojë pozicioni i punës inspektor jurist në një institucion kushtetues siç është Prefekti barazohet me atë të "juristit të nivelit të lartë në administratën publike", në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

Për më tepër, organet e ngarkuara me zgjedhjen e anëtarëve në institucionet e rivlerësimit (Avokati i Popullit dhe Kuvendi) termin "jurist i nivelit të lartë në administratën publike" i parashikuar nga pika 5 e Nenit "C" të Aneksit të Kushtetutës e kanë interpretuar në mënyrë shumë të zgjeruar duke barazuar me këtë pozicion pothuajse çdo pozicion që kandidatet kishin mbajtur në administratën publike shqiptare, duke përfshirë edhe atë të juristit të nivelit të ulët, pra juristit specialist. Po kështu edhe KED-ja në vendimet e saj, termin "nëpunës /jurist i nivelit të lartë në administratën publike" të parashikuar nga neni 125, pika 4 e Kushtetutës dhe neni 7/a, pika 2, shkronja "a", e ligjit nr. 8577/2000, e ka interpretuar në mënyrë shumë të zgjeruar, duke barazuar me këtë pozicion p.sh. edhe me pozicionin e specialistit në Drejtorinë e Kërkimit (specialist i lartë në Drejtorinë e Kërkimeve).

c)Komente lidhur me pozicionet e punës "Këshilltar ligjor" dhe "Drejtor" në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvendin e Shqipërisë.

Gjatë periudhës 16 prill 2007 - 12 prill 2010 kam ushtruar detyrën e "Këshilltarit jurist" në Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit dhe nga data 12 prill 2010 dhe në vijim ushtroj detyrën e "Drejtorit" të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit.

Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit është një nga 5 shërbimet që përbëjnë Shërbimin Legjislativ në Kuvend, i cili ka për mision t'i ofrojë Kuvendit, Komisioneve të Përhershme të Kuvendit dhe deputetëve asistencën e nevojshme tekniko-ligjore dhe shkencore në procesin e përafrimit të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë me legjislacionin e Bashkimit Europian (acquis e BE-së). Detyrat kryesore të SHPL në mbështetje të procesit ligjvënës të Kuvendit janë: i) të përgatisë opinione ligjore ose relacione për projektligjet që i paraqiten Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, të cilat synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së, ii) të plotësojë Tabelat e Përputhshmërisë për projektligjet të cilat i propozohen Kuvendit nga Deputetët, të cilat synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së.

Pozicionet e punës "Këshilltar ligjor" (prill 2007-prill 2010) dhe "Drejtor" i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit (prill 2010 dhe në vazhdim) në Kuvendin e Shqipërisë, barazohet plotësisht me atë të "juristit të nivelit të lartë në administratën publike", në kuptim të nenit 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000.

d)Komente lidhur me pozicionin e punës si lektor pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit "Gjon Buzuku" në Shkodër për periudhën mars 2011 - korrik 2014.

Gjatë periudhës mars 2011 - korrik 2014 kam qenë lektor i lëndës "E Drejta Institucionale e Bashkimit Europian", pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit "Gjon Buzuku" në

Shkodër. Ky pozicion pune barazohet plotësisht me pozicionin e "lektorit të së drejtës" në kuptimin e nenit 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000 (shih komentet në pikën 2/a lart).

3. Komente lidhur me përlllogaritjen e përvojës së punës prej 3 vite e 4 muaj si lektor pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit "Gjon Buzuku" në Shkodër, si periudhë e vjetërsisë në punë për efekt të kandidimit tim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë periudhës mars 2011 - korrik 2014 (3 vite dhe 4 muaj) unë kam punuar si lektor i jashtëm, (i punësuar me kohë të pjesshme) pranë Universitetit "Gjon Buzuku" në Shkodër. Siç rezulton edhe nga CV-ja ime, gjatë të njëjtës periudhe (mars 2011 - korrik 2014) unë kam qenë i punësuar edhe Drejtor i Shërbimit të Përafrimit në Kuvend, (i punësuar me kohë të plotë). Pra gjatë kësaj periudhe kohore prej 3 vite e 4 muajsh unë kam pasur një përvojë profesionale paralele, ose të mbivendosur në kohë në dy nga 6 llojet e veprimtarive profesionale që Kushtetuta dhe ligji parashikojnë për kandidatin për në Gjykatën Kushtetuese: "lektor i së drejtës" me kohë të pjesshme dhe "jurist i nivelit të lartë në administratën publike" me kohë të plotë. "Përvojë profesionale paralele", ose "e mbivendosur në kohë" do të thotë kur një punëmarrës në të njëjtën periudhe kohore ka më shumë se një përvojë profesionale të ligjshme.

Në kuptim dhe zbatim të drejtë dhe të saktë të kuadrit ligjor material të zbatueshëm në rastin konkret si dhe të standardeve ndërkombëtare në këtë fushë, vjetërsia ime në punë me kohë të pjesshme prej 3 vitesh e 4 muaj duhet llogaritur: i) në mënyrë të plotë, ii) të pjesshme, 50 %, iii) të pjesshme, sipas parimit "pro rata temporis", pra në proporcion me punën me kohë të plotë, dhe rezultati i përlllogaritjes duhet ti shtohet përvojës tjetër profesionale që unë kam prej 15 vite e 7 muaj në datën e aplikimit pranë Kuvendit dhe 15 vite e 8 muaj në datën e aplikimit pranë Presidentit të Republikës.

Ky interpretim, përlllogaritja e punës me kohë të pjesshme si periudhe e vjetërsisë në punë, pavarësisht nëse ajo i mbivendoset apo jo në kohë një periudhe tjetër punësimi me kohë të plotë apo të pjesshme, është në përputhje me legjislacionin material të zbatueshëm në rastin konkret:

- Legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë të zbatueshëm në rastin konkret: neni 125, pika 4 e Kushtetutës; neni 7/a, pika 2/a e ligjit nr. 8577/2000; neni 59, pikat 2 dhe 4 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë"; neni 8, pika 2 e ligjit Nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike".

- Të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë në rastin konkret: nenet 1, 4 dhe 9 të Konventës Nr. 175 "Puna me kohë të pjesshme (1994)" e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

- Legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë, i përafruar plotësisht me legjislacionin përkatës të BE-së lidhur me punën me kohë të pjesshme: neni 14, pikat 1 dhe 2 të Kodit të Punës, të cilat janë përafruar plotësisht me klauzolën 4 "Parimi i mos diskriminimit" të Shtojcës që i bashkëlidhet Direktivës së BE-së për punën me kohë të pjesshme;

Gjithashtu ky interpretim është në linjë edhe me standardet europiane në këtë fushë:

- Jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European (GJDBE) lidhur me kriteret dhe metodat e llogaritjes së përvojës profesionale: Vendimi i Gjykatës së Përgjithshme të Bashkimit European (GJPBE) i datës 15 shtator 2017, Komisioni European kundër FE, Çështja T-734/15, paragrafët: 27-30, 35, 40, 54, 60, 90, 101-104 e 109; Vendimi i Gjykatës së Shërbimit Civil të Bashkimit European (GJSHCBE) i datës 6 tetor 2015, FE kundër Komisioni European, Çështja F-119/14, paragrafët: 11, 19, 27, 31, 34, 47, 49-56; 61, 63, 68, 75 e 80; Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Bashkimit European të datës 31 janar 2006 Carla Giuliotti kundër Komisionit European, Çështja T-293/03, paragrafët: 71 e 72;

- Rregulloret e BE-së lidhur me kriteret e vlerësimit të përvojës profesionale part-time në procedurat e rekrutimit të stafit të Institucioneve të BE-së: nenet 27-43 "Rekrutimet" dhe Shtojca III "Konkurset" të Rregullores së Personelit të Zyrtarëve të Bashkimit Europian ; "Rregullat mbi Vlerësimin e Përvojës Profesionale", të miratuara nga Zyra për Përzgjedhjen e Stafit të BE-së (European Personnel Selection Office-EPSO) në datën 3 korrik 2012.

Dy janë pyetjet që shtrihen në këtë rast:

1) A e lejon kuadri ligjor në fuqi në rastin konkret përvojën profesionale paralele ose të mbivendosur në kohë, pra punësimin në të njëjtën kohë edhe si pedagog jashtëm (me kohë të pjesshme) edhe si nëpunës civil (me kohë të plotë)?

2) Nëse ligji e lejon përvojën paralele, si llogaritet në këtë rast kohëzgjatja e përvojës së punës me kohë të pjesshme, pra cilat janë kriteret ligjore dhe jurisprudenciale kombëtare dhe europiane për të llogaritur përvojën e punës me kohë të pjesshme ?

a. përvoja e punës me kohë të pjesshme llogaritet në të njëjtën mënyrë si ajo e punës me kohë të plotë (pra 100 %)?

b. përvoja e punës me kohë të pjesshme llogaritet 0.5 (ose 50 %) e punës me kohë të plotë?

c. përvoja e punës me kohë të pjesshme llogaritet në proporcion me punën me kohë të plotë (parimi pro rata temporis)?

d. përvoja e punës me kohë të pjesshme nuk llogaritet (pra 0 %)?

Lidhur me përgjigjen e pyetjes 1:

Kuadri ligjor në fuqi në Shqipëri (neni 8, pika 2 e ligjit Nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike") e lejon angazhimin e nëpunësit të administratës publike në veprimtarinë e jashtme të mësimdhënies, pra e lejon përvojën profesionale të mbivendosur në kohë të një nëpunësi të administratës publike brenda një viti kalendarik, duke lejuar edhe punësimin me kohë të pjesshme si lektor siç ishte rasti im gjatë periudhës mars 2011-korrik 2014.

Duke qenë se ligji e lejon angazhimin tim si lektor me kohë të pjesshme, ndërkohë që unë isha i punësuar si nëpunës civil me kohë të plotë, gjatë periudhës kur unë kam qenë lektor me kohë të pjesshme unë kam gëzuar të njëjtat të drejta si dhe kam përmbushur edhe të njëjtat detyrime si të punësuarit me kohë të plotë që kryenin të njëjtën punë, pra si lektorët me kohë të plotë në këtë Universitet. Gjatë periudhës mars 2011 - korrik 2014, kur unë kam qenë i punësuar si pedagog i jashtëm në Universitetin "Gjon Buzuku", në Shkodër unë kam përmbushur të gjitha detyrimet ligjore, duke paguar tatimin mbi të ardhurat personale (TAP), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe si lektor i jashtëm në Universitetin e sipërcituar edhe si nëpunës civil në Kuvend me kohë të plotë. Kështu vetëm gjatë periudhës janar-korrik 2014 tatimi mbi pagë që është mbajtur në burim nga Universiteti dhe është shlyer organeve tatimore ka qenë 52.604 lekë dhe kontributet e sigurimeve 7.864 lekë (shih vërtetimin e organeve tatimore bashkëlidhur).

Përmbushja e të gjitha detyrimeve që buronin nga punësimi im si lektor i jashtëm është e pavarur nga përmbushja e detyrimeve si i punësuar me kohë të plotë në Kuvend. Kjo do të thotë se edhe gëzimi i të drejtave si lektor i jashtëm është e pavarur nga gëzimi i të drejtës si i punësuar me kohë të plotë në Kuvend.

Për rrjedhojë bazuar në nenin 14, pika 2 të Kodit të punës i cili parashikon se "Punëmarrësit me kohë të pjesshme gëzojnë të njëjtat të drejta si punëmarrësit me kohë të plotë që kryejnë të njëjtën punë" unë kam të drejtë që periudha ime si i punësuar me kohë të pjesshme si lektor në universitetin e sipërcituar të më llogaritet në mënyrë të pavarur, (pra e plotë 3 vite e 4 muaj, ose e pjesshme në proporcion me punën me kohë të plotë), nga përvoja ime si nëpunës civil në Kuvend gjatë të njëjtës periudhë kohore. Për qëllim të llogaritjes të kësaj periudhe punësimi si përvojë profesionale nuk ka asnjë rëndësi fakti që gjatë kësaj periudhe unë kam qenë i punësuar si Drejtor i Shërbimit të Përafimit të Legjislacionit në Kuvend.

Lidhur me përgjigjen e pyetjes 2:

Në kuptim dhe zbatim të drejtë dhe korrekt të ligjit material vendas të zbatueshëm në rastin konkret (cituar më lart), të drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë në rastin konkret (Konventa Nr. 175 “Puna me kohë të pjesshme (1994)” e ILO, legjislacionit të BE-së lidhur me punën me kohë të pjesshme të përafëruar në legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë (Direktiva e BE-së 97/81/KE për punën me kohë të pjesshme), si dhe duke iu referuar jurisprudencës së GJDBE-së lidhur me kriteret dhe metodat e llogaritjes së përvojës profesionale part-time, dhe Rregulloret të BE-së lidhur me kriteret e vlerësimit të përvojës profesionale part-time, përvoja e punës me kohë të pjesshme, pavarësisht nëse i mbivendoset ose jo punës me kohë të plotë:

-llogaritet në të njëjtën mënyrë si puna me kohë të plotë, pra 100 % (shih Vendimin e GJSHCBE të datës 6 tetor 2015, FE kundër Komisioni European, Çështja F-119/14, paragrafët: 47, 52; 57, 61, 63, 68);

-llogaritet në një raport fiks 50 % e punës me kohë të plotë (shih Rregulloren mbi Vlerësimin e Përvojës Profesionale”, e miratuar nga EPSO në datën 3 korrik 2012), ose

-llogaritet në proporcion me punën me kohë të plotë (pro rata temporis) (shih Vendimin e GJPBE të datës 15 shtator 2017, Komisioni European kundër FE, Çështja T-734/15, paragrafët: 27-30, 35, 40, 54, 60, 90, 101-104 e 109), por në asnjë rast nuk llogaritet 0 %.

Nëse ligji në rastin konkret do të interpretohej në kuptimin që përvoja e punës me kohë të pjesshme nuk llogaritet (pra 0 %), kur ajo i mbivendoset një periudhe punësimi me kohë të plotë, kjo do të thotë që kërkesës për llojin e veprimtarisë profesionale “lektor i së drejtës” që Kushtetuta dhe ligji parashikojnë, i shtohet përmes interpretimit edhe një kriter tjetër shtesë i paparashikuar as në Kushtetutë as në ligj, i paarsyeshëm dhe për rrjedhojë arbitrar.

Rregulloret e BE-se dhe jurisprudenca e GJDBE-se lidhur me llogaritjen e përvojës profesionale:

Neni 270 i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE-së) parashikon se “Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European ka kompetencë mbi çdo mosmarrëveshje midis Bashkimit European dhe nëpunësve të tij, brenda kufijve dhe sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloret e Personelit të Zyrtarëve dhe të Kushteve të Punësimi të nëpunësit e tjerë të Bashkimit European”.

Rregulloret e Personelit të Zyrtarëve të Bashkimit European, (miratuar në vitin 1962 dhe e amenduar në vite) përcakton ndër të tjera rregullat lidhur me rekrutimin e stafit të BE-së (nenet 27-34) si dhe konkurset (Shtojca III) që zhvillohen për plotësimin e vendeve vakante në institucionet e BE-së. Sipas nenit 7 të shtojcës III të Rregullores së stafit të BE-së, Zyra Europiane e Përzgjedhjes së Stafit (ESPO), është përgjegjëse për të marrë masat e duhura për të siguruar që standarde uniforme zbatohen në procedurat e përzgjedhjes për zyrtarët e BE-së si dhe në procedurat e vlerësimit dhe të testimit të parashikuara në rregulloren e Stafit. Theksojmë faktin se ESPO në datën 3 korrik 2012 ka miratuar dokumentin me titull “Rregullat mbi vlerësimin e përvojës profesionale” i cili lidhur me punën part-time parashikon se: “Puna part-time llogaritet mbi bazën pro-rata të kohës së punës. Për shembull, nëse kandidati ka punuar part-time për 6 muaj, kjo punë i llogaritet si 3 muaj full-time.”

Mosmarrëveshjet që lindin mes BE-së dhe nëpunësve të tij në zbatim të Rregullores së Personelit të BE-së trajtohen nga GJDBE. Gjatë periudhës 2005-2016 këto mosmarrëveshje janë gjykuar nga Gjykata e Shërbimit Civil të BE-së (GJSHCBE), dhe nga viti 2016 GJSHCBE-ja është suprimuar dhe juridiksioni i saj i ka kaluar Gjykatës së Përgjithshme të BE-së.

Jurisprudenca e GJDBE-së lidhur me metodën e llogaritjes së punës part-time:

- Vendimi i GJSHCBE i datës 6 tetor 2015, FE kundër Komisioni European, Çështja F-119/14.
- Vendimi i GJPBE i datës 15 shtator 2017, Komisioni European kundër FE, Çështja T-734/15;

Dy vendimet e sipërcituara përbëjnë vendimet më të rëndësishme (i.e key case-laë) që GJDBE-së ka marrë në zbatim të Rregullores së Stafit të BE-së lidhur me metodën e llogaritjes së punës part-time për qëllim të plotësimit të kohëzgjatje minimale të kërkuar të përvojës profesionale.

Shkurtimisht paraqesim: i) rrethanat e faktit dhe kërkesat e paditëses FE në çështjen FE kundër Komisionit European, ii) Vendimin e GJSHCBE të datës 6 tetor 2015 dhe iii) Vendimin e GJPBE (apelit) të datës 15 shtator 2017.

i) Rrethanat e faktit të vendimit të GJSHCBE të datës 6 tetor 2015: Në datën 8 dhjetor 2005, ESPO publikoi shpalljen e konkursit për një listë pritjeje për jurist linguist ku si gjuhe kryesore kërkohej gjuha polake, me qëllim plotësimin e vakancave që mund të krijoheshin në institucione të ndryshme të BE-së në veçanti në GJDBE. Afati i fundit për të aplikuar ishte data 11 janar 2006. Në njoftimin e konkursit citohej se kërkohejshin “të paktën 2 vite përvojë profesionale”.

FE (shtetase polake) aplikoi për këtë pozicion në datën 27 dhjetor 2005. Në pjesën “Përvoja profesionale” të formularit të aplikimit FE kishte deklaruar se kishte 6 periudha përvojë profesionale me një kohëzgjatje totale prej 31 muajsh, nga të cilat 15 muaj si përkthyesë linguiste free - lance në Gjykatën e Drejtësisë së BE-së, gjatë periudhës 15 tetor 2004 deri në datën aplikimit (pra 27 dhjetor 2005) dhe 3 muaj si stazhiere (intern) në studion ligjore “W.law firm” në Bruksel gjatë periudhës 1 korrik - 30 shtator 2005 (shih paragrafin 11 të vendimit). Pra, periudha 3 mujore si stazhiere në studion ligjore “W.Law firm” ishte e mbivendosur në kohë me periudhën kur FE ishte edhe jursite lingusite free - lance në GJDBE 15 tetor 2004 - 27 dhjetor 2005.

FE u pranua në testimin e konkursit nga “Bordi i Pranimit”. Ky i fundit e përfshiu FE në listën e pritjes së konkursit, e vlefshme fillimisht deri në datën 31 dhjetor 2007, por ishte shtyrë disa herë derisa në datën 31 dhjetor 2013 i kaloi afati i vlefshmërisë.

Në datën 22 maj 2013 FE u ftua nga DG Justice për një intervistë lidhur me një mundësi rekrutimi të saj në postin e administratores në DG Justice. Në qershor 2013 FE u informua nga DG Justice se ajo është përzgjedhur për këtë post dhe se kërkesa e rekrutimit të saj i ishte përcjellë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DG Human Resources). Në muajin gusht 2013 DG Human Resources i kërkoj FE të paraqesë dokumentacionin që provon përvojën e saj profesionale prej 2 vitesh para datës së aplikimit.

Në datën 17 dhjetor 2013 Autoriteti i Emërimit (Appointing Authority) informoi FE se ajo nuk mund të rekrutohej nga DG Justice për shkak se nuk plotësonte kushtin e pranimit lidhur me përvojën profesionale minimale të kërkuar. Sipas Autoriteti i Emërimit FE kishte vetëm 22 muaj përvojë profesionale, pra më pak se 2 vite siç kërkohej në njoftimin e konkursit. Autoriteti i Emërimit i kishte njohur dhe llogaritur vetëm 7 muaj përvojë profesionale si juriste linguiste për Gjykatën e Drejtësisë dhe 2 muaj përvojë pune si intern në Studion Ligjore “W. Law Firm”, që nuk i korrespondonin 15 muajve dhe 3 muajve që FE kishte deklaruar.

Autoriteti i Emërimit në vendimin e tij argumenton se lidhur me përvojën e punës si juriste linguiste free - lance në Gjykatën e Drejtësisë, kohëzgjatja e kësaj përvoje pune ishte llogaritur mbi bazën e numrit total të faqeve të përkthyer (721) dhe një norme standard prej 5 faqesh në ditë që kërkohej nga juristët linguist të Komisionit. FE kundërshtoi këtë vendim, i cili nuk u pranua me një vendim të Autoritetit të Emërimit të datës 14 korrik 2014. Kurse përvojën e punës si intern në studio ligjore Autoritetit të Emërimit e kishte llogaritur mbi bazën e ditëve të prezencës në studio (40 ditë).

Në datën 24 tetor 2014 FE paraqiti padinë në GJSHC të BE-së me objekt: 1) shfuqizimin e vendimit të Autoritetit të Emërimit të 14 korrikut 2014 dhe 2) Dëshmipërblimin nga Komisioni European në shumën 26.132 euro për dëmin material dhe 1 Euro simbolike për dëmin moral të shkaktuar.

ii) Vendimi i GJSHCBE i datës 6 tetor 2015: GJSHBE-së me vendimin e datës 6 tetor 2015 i shfuqizoi vendimin e kontestuar të Autoritetit të Emërimit, 2) urdhëroi Komisionin të paguajë FE-së 10 000 euro.

GJSHCBE në vendimin e saj rrëzoi metodën përlllogaritjes së përvojës profesionale të FE që Autoriteti i Emërimit kishte përdorur (shih paragrafët 51, 56, 71, 93 të vendimit) dhe konfirmoi atë të Bordit të Pranimi, i cili i kishte njohur FE të plotë 15 muajt e përvojës profesionale si juriste linguiste dhe 3 muaj si stazhiere në studion ligjore në fjalë (shih paragrafët 47- 48 e 57, 61 të vendimit). Bordi i Pranimi kishte pranuar dhe llogaritur përvojën profesionale të FE të plotë 15 muaj, pra bazuar në datën e fillimit dhe të mbarimit të përvojës profesionale si dhe të plotë përvojën 3 muaj si stazhiere në studion ligjore gjithashtu, bazuar në datën e fillimit dhe të mbarimit të tij (shih paragrafet 33 e 34 të vendimit).

Kundër këtij vendimi Komisioni paraqiti kërkesë ankimore në Apel (GJPBE) në datën 17 dhjetor 2015, duke kërkuar: 1) shfuqizimin e vendimit të shkallës së parë, 2) rrëzimin e padisë së FE të paraqitur në shkallë të parë.

iii) Vendimi i GJPBE (apeli) i datës 15 shtator 2017

GJPBE me vendimin e saj të datës 15 shtator 2017 shfuqizoi vetëm pjesërisht vendimin e shkallës së parë vetëm për atë që ky vendim shfuqizon vendimin e Autoritetit të Emërimit me arsyetimin se ky Autoritet nuk ishte kompetent për të marrë vendimin për mosrekrutimin e FE-së (shih paragrafin 92 të vendimit). Gjithashtu GJPBE shfuqizoi pjesën e dispozitivit të vendimit të shkallës së parë që urdhëronte Komisionin të paguajë FE 10.000 euro.

Lidhur me metodën e njohjes dhe llogaritjes së përvojës profesionale, vendimi i GJPBE i datës 15 shtator 2017, në paragrafin 27 përcakton se:

“Gjykata ka përcaktuar në paragrafët 71 e 72 të vendimit të datës 31 janar 2006 Giulietti kundër Komisionit (T-293/03) se, duke kërkuar që veprimtaria profesionale të jetë kryer për një periudhë minimale, njoftimi i konkursit kërkonte detyrimisht realizimin efektiv të atij aktiviteti gjatë periudhës në fjalë, i cili për rrjedhojë duhet të kuptohet se i referohet një periudhe të punës së kryer me kohë të plotë gjatë kësaj periudhe të kohës minimale, ose një periudhe pune të kryer gjatë një ose disa periudhave të punës me kohë të pjesshme, ekuivalente, (në terma të kohës së punës) me periudhën me kohë të plotë minimale. Pra Bordi i Përzgjedhjes, mund të llogariste dhe të merrte në konsideratë, për qëllim të pranimit të kandidatëve të jashtëm, periudha të përvojës profesionale jo-ekskluzive dhe me kohë të pjesshme, me kusht që totali i këtyre periudhave të arrijë minimumin e periudhës së kërkuar me kohë të plotë”.

Konkluzionet lidhur me këto 2 vendime:

-Vendimi i GJPBE (apeli) lë në fuqi pjesët e vendimit të shkallës së parë që konfirmojnë metodën e përlllogaritjes të përdorur nga Bordi i Përzgjedhjes, i cili siç e theksuam më lart punën part-time si juriste linguiste të FE e kishte llogaritur të plotë 15 muaj dhe punën si intern të plotë 3 muaj, duke u bazuar në datat e fillimit dhe të përfundimit të këtyre 2 përvojave profesionale, dhe për më tepër duke llogaritur të plotë dhe në mënyrë të pavarur dhe kumulative edhe stazhin 3 mujor (1 korrik-30 shtator 2005) i cili i mbivendosej në kohë punës part-time si juriste linguiste (15 tetor 2004 - 27 dhjetor 2005).

-Gjithashtu Vendimi i GJPBE (apeli) konfirmoi edhe metodën e përdorur nga Autoriteti i Emërimit, i cili përvojën profesionale të FE nuk e llogariti të plotë, por si ekuivalent të punës full-time, pra në proporcion me punën e kryer: nga 15 muaj përvojë profesionale part-time si juriste linguiste Autoriteti i Emërimit njeh dhe pranon si ekuivalent të 7 muajve full-time (ose

46 %) dhe nga 3 muaj përvojë si intern në studio ligjore "W. Law firm" njeh dhe llogarit si ekuivalent të 2 muajve full-time (ose 64 %).

-Dy vendimet e sipërcituara konfirmojnë 2 metodologji të ndryshme për Bordin e Përzgjedhjes dhe Autoriteti i Emërimit lidhur me llogaritjen e punës part-time, bazuar në parimin e pavarësisë vendimmarrëse që të dy këto organe kanë.

Lidhur me fuqinë detyruese të jurisprudencës së GJDBE-së për organet administrative dhe gjyqësore shqiptare:

Neni 70 i MSA-së BE - Shqipëri parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me "acquis të BE-së", pra me legjislacionin e BE-së. Acquis e BE-së përbëhet nga: legjislacioni i parësor i BE-së (nuk përafrohet por legjislacioni shqiptar duhet të jetë në përputhje me të), legjislacioni dytësor (direktiva, rregullore dhe vendime) i cili duhet të përafrohet nga Shqipëria përmes metodës legjislative (pra përmes ndryshimit, shfuqizimit të legjislacionit aktual ose miratimit të ligjeve të reja).

Në konceptin e "acquis së BE-së" përfshihet edhe jurisprudenca e GJDBE-së. Jurisprudenca e GJDBE-së është e detyrueshme për gjykatat shqiptare, në rastet kur gjykatat shqiptare interpretojnë një ligj shqiptar i cili është përafruar me legjislacionin e BE-së. Neni 14 i Kodit të Punës, (ndryshuar me Ligjin 136/2015, datë 5.12.2015) është përafruar plotësisht me klauzolën 4 "Parimi i mosdiskriminimit" të Shtojcës që i bashkëlidhet Direktivës së BE-së për punën me kohë të pjesshme. Në këtë rast qëllimi dhe konceptet ligjore duhet të interpretohen nga gjykata shqiptare sipas qëllimit dhe përmbajtjes së nenit përkatës të aktit ligjor të BE-së me të cilin është përafruar ligji shqiptar si dhe sipas jurisprudencës së GJDBE-së që e ka interpretuar aktin përkatës ligjor të BE-së. Kjo quhet edhe metoda gjyqësore ose indirekte e përafrimit, e cila konsiston në interpretimin proeuropian të ligjit vendas nga gjykatat shqiptare.

Në rastin konkret neni 270 i TFBE-së dhe Rregullorja e Personelit të Zyrtarëve të Bashkimit Europian si dhe jurisprudenca e sipërcituar e BE-së që e interpretuar ato, përbëjnë acquis të BE-së, dhe për rrjedhojë ato merren në konsideratë nga gjykatat shqiptare dhe autoritet administrative shqiptare siç është KED-ja.

Për rrjedhojë, në dritën e kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e sipërcituar e GJDBE-së dhe nga ESPO lidhur me metodën e llogaritjes së përvojës profesionale, përvoja ime profesionale prej 3 vite e 4 muaj si "lektor i së drejtës" në Universitetin "Gjon Buzuku" në Shkodër, gjatë periudhës mars 2011-korrik 2014, duhet të llogaritet nga KED-ja si vijon:

- E plotë (3 vite e 4 muaj), dhe e pavarur nga përvoja ime si jurist i nivelit të lartë në administratën e publike (Vendimi i GJSHCBE i datës 6 tetor 2015, FE kundër Komisioni Europian, Çështja T-734/15 që konfirmon metodën llogaritjes të Bordit të Pranimit); ose,

- Si ekuivalent i punës me kohë të plotë në një raport që varion nga 46 % (1 vit e 6 muaj) në 64 % (2 vite e 1 muaj) i punës me kohë të plotë (Vendimi i GJPBE i datës 15 shtator 2017, Komisioni Europian kundër FE, Çështja T-734/15 që konfirmon metodën e përllogaritjes të Autoritetit të Emërimit), ose,

- 50 % (1 vit e 8 muaj) sipas Udhëzimeve të ESPO-s të datës 3 korrik 2012.

Në përfundim,

Bazuar në shpjegimet e dhëna më sipër, kërkojmë që Ju të nderuar Anëtarë - Relatorë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi:

a) të marrë në konsideratë sqarimet dhe dokumentacionin shoqërues të tyre lidhur me barazvlefshmërinë e pozicioneve të punës të deklaruara nga ana ime, për efekt të kandidimit tim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me ato në kuptim të nenit 7/a, pika 2, shkronja "a" të i ligjit nr. 8577/2000.

b) të konstatojë plotësimin nga ana ime të kriterit ligjor të përvojës në punë për të qenë kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese ("jo më pak se 15 vjet si ... lektor i së drejtës,

jurist i nivelit të lartë në administratën publike”, të përcaktuar në nenin 7/a, pika 2, shkronja “a” të i ligjit nr. 8577/2000).”

48. Bazuar në gjetjet e cituara si më sipër, Këshilli konstaton se kandidati Dedë Kasneci **nuk ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.**

49. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”.

50. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) **të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;***
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.*

51. Në kuptim dhe zbatim të drejtë të këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, nisur nga të dhënat mbi kohëzgjatjen dhe llojin e veprimtarisë profesionale të ushtruar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi arrin në përfundimin se kandidati Dedë Kasneci nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë për të qenë kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, duke qenë se ai ka më pak se 15 vite përvojë pune në pozicionet e kërkuara nga neni 125 i Kushtetutës dhe neni 7/a i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

52. Gjatë karrierës së tij, ky kandidat ka ushtruar edhe funksionin “*Inspektor Jurist në Institucionin e Prefektit Qarku Shkodër në periudhën 12 mars 2001- maj 2003*”, pra për një periudhë prej 2 vjet e 2 muaj. Këshilli vlerëson se kjo përvojë e kandidatit nuk futet në rrethin e atyre të përcaktuara nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës apo pika 2 e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Sipas nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i cili klasifikon pozicionet në shërbimin civil në një institucion të administratës shtetërore, dhe administrata e prefektit është institucion i administratës shtetërore sipas pikës 1 shkronja “a” të nenit 4 të ligjit të cituar, detyra e kryer nga kandidati si inspektor jurist në prefekturë nuk përfshihet në klasifikimin e juristit të nivelit të lartë në administratën publike. Përkundrazi, me referimin të VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, termi inspektor barazohet me atë të specialistit që është kategoria e IV, dhe me e ulëta e nëpunësit civil (i kategorisë ekzekutive) në administratën shtetërore e, për rrjedhojë, edhe në atë publike.

53. Edhe nëse referimi bëhet të ligji i kohës nr. 7608, datë 22.09.1992 “Për Prefekturat”, në zbatim të të cilit doli edhe VKM nr. 202, datë 26.03.1998 “Për detyrat e aparatit administrativ të Prefekturës”, i cili parashikon edhe strukturën tip të prefekturës, qartazi evidentohet se nëpunësi më i ulët i zyrës juridike është inspektori juridik, për çka dhe aspak i përputhur me kërkesën e juristit të nivelit të lartë në administratën publike të kërkuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës apo pika 2 e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

54. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se kandidati ka edhe eksperiencë si: *Lektor i lëndës “E Drejta Institucionale e Bashkimit Europian” Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti “Gjon Buzuku” Shkodër, vitet akademike 2011 - 2012, 2012 - 2013, 2013 - 2014*. Këshilli mban parasysh faktin se në vitet akademike kur kandidati ka qenë pedagog i jashtëm, njëkohësisht ka qenë i punësuar edhe në Kuvend dhe kjo eksperiencë është e mbivendosur dhe nuk mund të llogaritet në plotësimin e kriterit kushtetues dhe ligjor.

55. Në përfundim, Këshilli konstaton se kandidati Dedë Kasneci nuk ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 **ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për mospërbushje të kriterit ligjor të veprimtarisë profesionale 15 vjeçare në njërën ose bashkërisht në ato të gjyqtarit, prokurorit, avokatit, lektorit të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.**

56. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367/2005), ILDKPKI-ja, me shkresën nr. 4340/1 prot., datë 03.12.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Dedë Kasneci dhe personat e lidhur me të.

57. Në përfundim të analizës së hollësishtme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Dedë Kasneci, ILDKPKI-ja në raportin e paraqitur, shkresa nr. 119/25 prot., datë 03.12.2019, ka ardhur në përfundimet se:

a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*

b) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive;*

- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

58. Mbi gjetjet e sipërcituara, ILDKPKI-ja në raportin përfundimtar konstaton se në përfundim të kontrollit ka rezultuar se:

- Janë të paqarta transaksionet e kryera lidhur me shlyerjen e këstit të parë prej 23.000 Euro të apartamentit me sipërfaqe 64.5 m² në Tiranë, pasi kjo shumë fillimisht është dhënë hua nga kandidati tek pala shitëse në datën 13.11.2012 dhe pas 9 ditësh, nënshkruhet kontrata e shitblerjes së apartamentit, sipas së cilës kësti i parë në vlerën 23.000 Euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe para nënshkrimit të aktit përmes bankës Credins sh.a.; sipas deklaratës noteriale datë 3.6.2019, shuma 23.000 Euro e dhënë hua nga kandidati, është përdorur për shlyerjen e këstit të parë apartamentit;
- Dokumentacion jo i plotë financiar, lidhur me burimin e krijimit të shumës 15.965 Euro në vitin 2012, dhënë nga shtetasja Vjollce Kroni (motra), e përdorur si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 64.5 m², në Tiranë, pasi sipas dokumentacionit të paraqitur, të ardhurat familjare të saj deri në vitin 2012, rezultojnë rreth 40.000 Euro (pa përfshirë shpenzimet e jetesës);
- Në deklaratat e interesave private 2012 - 2018, nuk është deklaruar si detyrim financiar huamarrja nga motra në shumën 15.965 Euro, por është deklaruar si remitancë (e ardhur nga emigracioni) në deklaratat e interesave private për vitet 2012 – 2014;
- Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të huasë në shumën 5.800 Euro, shumë e cila është përdorur për arredimin e apartamentit në vitin 2014.
- Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për pronësinë e banesave të të afërmeve në adresat e deklaruara të banimit në rrugën "Arkitekt Kasemi, dhe "Bardhyl", Tiranë.

59. Kandidati Dedë Kasneci është njoftuar për konkluzionin e ILDKPKI-së dhe në datën 12.11.2019 ka depozituar shpjegimet përkatëse në rrugë elektronike me e-mail, si dhe ka paraqitur bashkëlidhur dokumentacion justifikues duke pretenduar se:

- ❖ Lidhur me gjetjen e Aktit të Kontrollit të ILDKPKI-së sipas së cilës: "Janë të paqarta transaksionet e kryera lidhur me shlyerjen e këstit të parë prej 23.000 euro, të apartamentit me sip. 64.5 m² në Tiranë, pasi kjo shumë fillimisht është dhënë hua nga kandidati tek pala shitëse në datën 13.11.2012 dhe pas 9 ditësh, nënshkruhet kontrata e shitblerjes së apartamentit, sipas së cilës kësti i parë në vlerën 23.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe para nënshkrimit të aktit përmes bankës Credins; sipas deklaratës noteriale datë 3.6.2019, shuma 23.000 euro e dhënë hua nga kandidati, është përdorur për shlyerjen e këstit të parë të apartamentit", sqarojmë sa vijon:

Marrëdhënia juridike që është krijuar mes meje si subjekt deklarues dhe shtetates Andriana (Adriana) Lanidhi për dhënien hua të shumës 23.000 euro, sipas kontratës noteriale me Nr. 3052 Rep., Nr. 917 Kol ., datë 13.11.2012 si dhe transaksionet e kryera lidhur me përdorimin e kësaj shume për shlyerjen e këstit të parë të apartamentit me sip. 64.5 m² që unë kam blerë nga Znj.Lanidhi, janë shumë të qarta, janë të deklaruara dhe të dokumentuara përmes akteve përkatëse noteriale dhe bankare si më poshtë:

- Gjatë vitit 2012 unë dhe Znj.Lanidhi kemi rënë dakord për të lidhur një kontratë shitblerjeje me objekt blerjen e një apartament banimi që ajo kishte në pronësinë e saj, e cila ndodhet në Rrugën "B.Luga", Tiranë dhe me sipërfaqe 64.5 m².
- Gjithashtu me Znj.Lanidhi une kam rënë dakord që çmimi i shtitjes së apartamentit të banimit të jetë në shumën 58.700 euro.

- Me Znj.Lanidhi kemi rënë dakord që shuma 58.700 euro të likujdohej në 2 këste:
- Kësti i parë në shumën 23.000 euro është rënë dakord që të likujdohej nga ana ime përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes së apartamentit, pasi Znj. Lanidhi duhej të shlyente menjëherë një detyrim në mjete monetare në shumën 23.000 euro që ajo kishte ndaj një personi të tretë.

Duke qenë se shlyerja e kështit të parë për blerjen e apartamentit në shumën 23.000 euro do të bëhej përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes së apartamentit, me qëllim dokumentimin përmes një akti notarial të shlyerjes së kështit të parë në shumën 23.000 euro, në datën 13.11.2012 unë kam lidhur një Kontratë Huadhënie Mjete Monetare Nr. 3052 Rep., Nr. 917 Kol., ku palë huadhënëse isha unë dhe palë huamarrëse ishte Znj.Lanidhi me objekt dhënien hua të shumës 23.000 euro me afat nga data 13.11.2012 deri më 31.12.2012 pa interes (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.1). Është zgjedhur kjo mënyrë dokumentimi për të krijuar sigurinë e të dy palëve në lidhje me vërtetimin e marrëdhënies juridike. Nëse kontrata e shit-blerjes së apartamentit nuk do të realizohej/ lidhej, unë do të kisha një mjet juridik (kontratën e huadhënies mjete monetare) për të kërkuar kthimin e shumës prej 23.000 euro. Ndërsa pala tjetër (Znj.Lanidhi) kishte sigurinë sepse i ishte shlyer kësti i parë i apartamentit në shumën 23.000 euro.

Po në datën 13.11.2012 përmes Bankës Credins unë i kam paguar Znj.Lanidhi shumën 23.000 Euro (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.2). Burimi i këtyre të ardhurave është deklaruar dhe është si vijon: 1) Kredi Bankare me Bankën Credins sh.a., në datën 13.11.2012, shuma 1,000,000 Lekë, e cila është blerë nga BKT në datën 14.12.2012, 2) Huamarrje nga motra në Itali, në vitin 2012 në shumën 15.965 Euro.

- Në datën 22.11.2012 është lidhur kontrata e shit-blerjes së pasurisë së paluajtshme me kusht kreditimi Nr. 2300 Rep., Nr. 776 Kol., me palë shitëse shtetasen Adriana Lanidhi dhe palë blerëse unë Dedë Kasneci, me objekt shitjen e një apartament banimi me sipërfaqe 64.5 m2. Në nenin 3 “Çmimi dhe kushtet e shitjes” të kësaj Kontrate parashikohet se çmimi i shitjes së apartamentit është 58.700 Euro, e cila do t’i likujdohet palës shitëse (Adriana Lanidhi) nga pala blerëse (Dede Kasneci) në 2 këste:
 - o Kësti i parë në shumën prej 23.000 euro është likujduar përpara nënshkrimit të këtij akti përmes Bankës Credins (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.3).
 - o Ndërsa kësti i dytë në shumën 35.700 euro do të likujdohet përmes Bankës BKT ku pala blerëse ka aplikuar si kredimarrës Brenda afatit kohor 30.12.2012.
- Kësti i dytë në shumën 35.700 Euro është likujduar përmes BKT në datën 23.1.2013. Burimi i krijimit të ardhurave: Kredi Bankare nga BKT në datën 14.12.2012 në shumën 5.000.000 Lekë.
- Në datën 24.1.2013 Adriana Lanidhi (pala shitëse) dhe unë (pala blerëse) kemi nënshkruar deklaratën noteriale Nr.108 Rep., dhe Nr.31 Kol., përmes të cilës deklarohet se: i) është likujduar plotësisht shuma 58.700 Euro për të cilën palët kishim rënë dakord si vlerë të apartamentit të banimit, 2) prona mund të rregjistrohet në emrin e blerësit (shih dokumentin shoqërues nr. 4).
- Në Deklaratën e Interesave Private Periodik Vjetor 2012 që unë kam depozituar në ILDKPKI në datën 31 mars 2013, shlyerja e kështit të parë në shumën 23.000 Euro për blerjen e apartamentit të sipërcituar është deklaruar në pjesën “Ndryshimi i Pasurive dhe Burimi i Krijimit” si vijon: “Kësti i parë në shumën 23.000 Euro Likujduar përmes Bankës Credins në datën 13.12.2012” (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.5).
- Referuar në shpjegimet e dhëna më sipër, rezulton se marrëdhënia juridike që është krijuar mes meje si subjekt deklarues dhe Znj.Lanidhi për dhënien hua të shumës 23.000 euro, sipas kontratës noteriale me Nr. 3052 Rep., Nr. 917 Kol., datë 13.11.2012, si dhe transaksionet e kryera lidhur me përdorimin e kësaj shume për shlyerjen e kështit të parë të apartamentit me sip. 64.5 m2 që unë kam blerë nga znj.Lanidhi, janë shumë të qarta:

Kjo është një marrëdhënie juridike e krijuar mes palës shitëse (znj.Lanidhi) dhe palës blerëse (unë) gjatë procesit të negocimit, përfundimit dhe zbatimit të kontratës së shitblerjes së një apartamenti banimi nga ana ime, proces i cili ka zgjatuar në kohë për disa muaj (tetor 2012 - janar 2013), dhe i cili ka konsistuar në kryerjen e disa veprimeve juridike të njëpasnjëshme dhe të ndryshme, duke përfshirë edhe lidhjen e kontratës së huasë mes meje dhe znj.Lanidhi në shumën 23.000 euro, për qëllim të shlyerjes së këstit të parë të pagesës së çmimit të apartamentit të banimit që unë kam blerë nga znj.Lanidhi.

- Për të sqaruar situatën e paqartë të marrëdhënies juridike që unë, sipas Raportit të kontrollit të ILDKPKI-së, kam me shtetasen Adriana Lanidhi për dhënien hua të shumës 23.000 euro, sipas kontratës nr.3052/917 datë 13.11.2012, me anë të Deklaratës Noteriale për Revokim Kontratë Huamarrje Mjete Monetare, të datës 3 qershor 2019, secila nga palët deklaroi pozicionin e saj në lidhje me kontratën e huadhënies së sipërcituar:
 - o Palët (unë dhe Znj.Lanidhi) me vullnetin tonë të plotë, të lirë dhe të pavesuar deklarojmë se revokojmë kontratën e huasë mjete monetare me Nr. 3052 Rep., Nr. 917 Kol., datë 13.11.2012 (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.6).

- ❖ Lidhur me gjetjen e raportit të ILDKPKI-së, sipas së cilës: “Dokumentacion jo i plotë financiar, lidhur me burimin e krijimit të shumës 15.965 euro në vitin 2012, dhënë nga shtetasja Vjollcë Kroni (motra), e përdorur si burim për blerjen e apartamentit me sip. 64.5 m2, në Tiranë, pasi sipas dokumentacionit të paraqitur, të ardhurat familjare të saj deri në vitin 2012, rezultojnë rreth 40.000 Euro (pa përfshirë shpenzimet e jetesës)” sqarojmë sa vijon:

Deklaratave të Pasurisë dhe të Interesave Privatë të Kandidatit që unë kam dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.4.2019 dhe 14.10.2019, i kam bashkëlidhur edhe Deklaratën Noteriale Nr.759 Rep., Nr. 364 Kol., datë 18.4.2019 me palë deklaruese motrën time Vjollcë Kroni rezidente në Itali, e cila deklaroi se më ka dhënë hua në vitin 2012 shumën 15.965 Euro, pa afat dhe pa interes për tu përdorur për të blerë një apartament banimi.

- Në këtë deklaratë noteriale motra ime deklaroi se: “Kjo shumë është realizuar nga kursimet e punësimit të rregullt në Itali nga vitit 2001 dhe në vijim së bashku me bashkëshortin tim Z.Kole Kroni” (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.7).
- Motra ime Vjollcë Kroni së bashku me familjen e saj (bashkëshortin Kolë Kroni) është rezidente në Itali nga viti 2001 dhe në vijim.
- Bashkëlidhur dërgohet dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e financimit të shumës 15.965 Euro që motra ime Vjollcë Kroni më ka dhënë në vitin 2012 për ta përdorur për blerjen e apartamentit:

-Vërtetim i lëshuar në datën 24 Maj 2019 nga punëdhënësi italian (Z. Lorenzo Sachetto), përmes të cilit vërtetoi se Vjollcë Kroni dhe Kole Kroni janë të punësuar në ndërmarrjen që ai drejton nga viti 2010 dhe në vijim (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.8).

-Vërtetim i lëshuar në datën 24 Maj 2019 nga punëdhënësi italian (Domenico Sachetto), përmes të cilit vërtetoi se Vjollcë Kroni dhe Kole Kroni kanë qenë të punësuar në ndërmarrjen që ai drejtonte nga viti 2005 deri në vitin 2009 (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr. 9).

-Sqarojmë se për periudhën 2001-2005 ka qenë e pamundur për të marrë vërtetim nga ish-punëdhënësi për shkak të ndërmarrjes ku motra dhe bashkëshorti i saj kanë punuar gjatë kësaj periudhe kanë falimentuar.

-Kreditimin e pagës (Buste-paga) të Vjollcë kroni dhe Kolë kroni për periudhën 2001-2012 (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.10).

-Certifikatën e të Ardhurave nga Punësimi në shtetin italian (CUD) të Vjollcë Kroni dhe Kolë Kroni për periudhën 2001-2008 dhe 2010-2012 (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.11). Sqarojmë se në dokumentacionin që i është bashkëlidhur Deklaratës të Pasurisë dhe të Interesave Privatë të Kandidatit që unë kam dorëzuar në ILDKPKI në datën 14.10.2019 mungon CUD-i i viteve 204-2005 dhe vitit 2009.

-Sipas përlllogaritjeve të ILDKPKI-së, të ardhurat familjare të motrës time deri në vitin 2012 rezultojnë “rreth 40.000 Euro”.

- Së pari, theksojmë ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin financiar të paraqitur, duhet të jepte shumën e saktë të të ardhurave familjare të motrës time deri në vitin 2012 dhe jo të bazonte konkluzionet e saj në shumën të përlllogaritura me përafërsi “... rreth 40.000 Euro ...” (fq.6 dhe 14 të Aktit të Kontrollit). Duke qenë se dokumentacioni financiar i paraqitur ishte në gjuhën italiane, nuk është e qartë nëse personi i caktuar nga ILDKPKI-ja për të përlllogaritur të ardhurat familjare të motrës time, zotëronte gjuhën italiane apo kishte njohuri të posaçme për të trajtuar një dokumentacion financiar relativisht kompleks dhe voluminoz (225 fq.) të lëshuar nga punëdhënësi italian dhe autoritete financiare të shtetit Italian (*Buste-paga dhe CUD-e*).

-Së dyti, edhe duke e pranuar si të saktë shumën 40.000 Euro të përlllogaritur nga ILDKPKI-ja, rezulton se kjo shumë është 2.5 herë më e madhe sesa shumën që motra ime më ka dhënë hua në vitin 2012 (15.965 Euro), dhe për rrjedhojë nuk është e qartë baza apo kriteri ligjor se ku e bazon ILDKPKI-ja konkluzionin e saj se dokumentacioni financiar lidhur me burimin e krijimit të shumës 15.965 euro, që motra ime më ka dhënë hua në vitin 2012, është i paplotë.

-Bashkëlidhur paraqesim dokumentacionin e plotë financiar të ardhurave familjare të motrës time në Itali nga viti 2001 deri në vitin 2012, kur më ka dhënë huanë. Sipas dokumentacionit të plotë financiar (Estratto Conto Previdenziale - INPS) të lëshuar nga autoritetet italiane për periudhën e punësimit të saj në Itali nga viti 2001 deri në vitin 2012, kur më ka dhënë huanë, shumën totale të ardhurave të saj familjare është 68.939 Euro, (shih bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues nr.12 dhe 13). Ky është një dokumentacion i ri që paraqitet për herë të parë.

-Pra rezulton se shumën e të ardhurave familjare të motrës time nga viti 2001 deri në vitin 2012, kur më ka dhënë huanë është 4.3 herë më e madhe sesa shumën që motra ime më ka dhënë hua në vitin 2012.

-Lidhur me shpenzimet e jetesës së motrës time Vjollcë Kroni, rezidente në Itali sqarojmë se: Deri në vitin 2012, por edhe në vijim ajo dhe bashkëshorti i saj (Kole Kroni) jetojnë në një provincë të vogël të Torinos (Itali) me shpenzime minimale jetese dhe si të gjithë emigrantët shqiptarë në Itali bëjnë një jetë të thjeshtë. Gjithashtu ata nuk kanë shpenzime jetese shtesë sepse janë vetëm ajo dhe bashkëshorti i saj.

❖ Lidhur me gjetjen e raportit të ILDKPKI-së se: “Në deklaratat e interesave private 2012-2018, nuk është deklaruar si detyrim financiar huamarrja nga motra në shumën 15.965 Euro, por është deklaruar si remitanca (e ardhur nga emigracioni) në deklaratat e interesave private për vitet 2012-2014”, sqarojmë sa vijon:

- Në Deklaratat e Interesave Privatë Periodikë/ Vjetor 2012 dhe 2013, shumën 15.965 euro që unë kam marrë hua nga motra ime (Vjollcë Kroni) në vitin 2012 është deklaruar në pjesën “Ndryshimi i Pasurive dhe Burimi i i Krijimit” si burim i krijimit të pasurisë si vijon: “remitanca (të ardhura nga emigracioni viti 2012)”.
- Kurse në Deklaratën e Interesave Privatë Periodikë/ Vjetor 2014 kjo shumë e marrë hua nga motra ime është deklaruar në pjesën “Ndryshimi i Pasurive dhe Burimi i Krijimit” si burim i krijimit të pasurisë si vijon: “Remitanca nga të afërm jashtë shtetit..”.

- Së pari, sqarojmë se termi anglisht “remitancë” në shqip përkthehet si “e ardhur nga emigracioni”, prandaj në deklaratat e pasurisë të viteve 2012-2014 është përdorur ky term i përkthyer nga gjuha angleze.
- Së dyti, termi “remitanca (të ardhura nga emigracioni viti 2012)” është deklaruar për të provuar burimin e krijimit të ardhurave, por nuk është deklaruar si e ardhur në pjesën “Të ardhurat dhe Angazhimet në Veprimtari Publike ose Private” të deklaratave të interesave private periodik vjetor 2012-2014 (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr. 14). Pra e kam deklaruar në faqen e gabuar.
- Në deklaratat e Pasurisë dhe të Interesave Privatë të Kandidatit që unë kam dorëzuar në ILDKPKI në datën 24 prill 2019 dhe 14.10.2019, shuma 15.965 Euro e marrë hua nga motra ime (Vjollcë Kroni) është deklaruar si vijon:
 - Në faqen e deklaratës lidhur me deklarimin e pasurive dhe burimin e krijimit është deklaruar: “Remitanca (të ardhura nga emigracioni) nga një i afërm. Huamarrje nga një person fizik në shumën 15,965 Euro...”.
 - Në faqen e deklaratës lidhur me detyrimet financiare ndaj personave juridik e fizik është deklaruar si detyrim financiar: “Huamarrje nga person fizik në vitin 2012 në shumën 15,965 Euro, ose vlerë ekuivalente 2,231,907 lekë, për blerje apartament banimi. Huaja është dhënë pa afat dhe pa interes”.
 - Në faqen e deklaratës “Të dhëna personale” është deklaruar si vijon: “Huamarrje nga Znj.Vjollce Kroni (motra e Deklaruesit) në shumën 15,965 euro, ose vlerë ekuivalente 2,231,907 lekë (sipas kursit të këmbimit të euros me lekun në vitin 2012)” (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.15).
- Së fundi, sqarojmë se **Deklarata Noteriale nr.759 Rep., Nr. 364 Kol., datë 18.4.2019** që motra ime (Vjollcë Kroni) rezidente në Itali, ka nënshkruar, konfirmon në mënyrë të qartë se shuma 15.965 Euro është një detyrim financiar huamarrje që unë kam ndaj motrës time (shih dokumentin shoqërues nr.7 lart).
- ❖ Lidhur me gjetjen e raportit të ILDKPKI-së se: “Mungon Dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të huas në shumën 5.800 euro, shumë e cila është përdorur për arredimin e apartamentit, në vitin 2014” sqarojmë sa vijon:
 - **Bashkëlidhur paraqesim Deklaratën Noteriale Nr. 5806 Rep., Nr.3071 Kol., datë 11.11.2019** me palë deklaruese shtetasen Andriana (Adriana) Lanidhi, e cila deklaroi se në vitin 2014 më ka dhënë hua shumën 5.800 Euro (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.16):
 - Kjo shumë më është dhënë hua pa interes dhe është rënë dakord që të shlyhej me këste sipas aftësisë/ mundësive të mia paguese gjatë viteve të ardhshme.
 - Kjo hua më është dhënë për t’u përdorur nga ana ime për nevoja familjare, për të mundësuar arredimin e apartamentit të banimit që unë i kam blerë Znj.Lanidhi në datën 22 nëntor 2012 (shih dokumentacionin shoqërues nr.3 lart).
 - Znj.Lanidhi dhe unë nuk kishim nevojë të legalizonim marrëdhënien e huas me një kontratë huaje, për shkak të besimit reciprok dhe të marrëdhënieve të miqësisë që kishim krijuar nga fqinjësia e mirë, duke qenë se ne banojmë në të njëjtin pallat (Rr. “B. Luga”, Pallati 13, Shkalla 1) nga muaji nëntor 2012 dhe në vijim.
 - Znj.Lanidhi deklaroi se: “Paratë që i kam dhënë hua Z. Kasneci i kam pasur gjendje për shkak të të ardhurave të krijuara nga shitja e apartamentit që unë kisha në pronësi (Rruga “B. Luga”, Pallati 13, Shkalla 1, Apartamenti 37) dhe të cilin ia kam shitur Z. Kasneci në datën 22 nëntor 2012. Këto të ardhura janë të ligjshme, sepse unë deklaroj me përgjegjësi se janë paguar të gjitha detyrimet tatimore (tatimi mbi të ardhurat nga shitja)”, (shih bashkëlidhur dokumentin shoqërues nr.17).
 - Këtë hua ia kam shlyer Znj.Lanidhi me këste gjatë viteve 2015-2017.

- ❖ Lidhur me gjetjen e raportit të ILDKPKI-së se: “Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për pronësinë e banesave të të afërme në adresat e deklaruarat të banimit në Rrugën “Arkitekt Kasemi” dhe “Bardhyl”, Tiranë.” sqarojmë sa vijon:
 - Lidhur me adresën e banimit, Arkitekt Kasemi, Tiranë, e deklaruar në Deklaratën e Interesave Private Periodik/ Vjetore 2010, si vendqëndrim tjetër përveç adresës së plotë të gjendjes civile, sqarohet se:
 - Në këtë adresë kam jetuar për një periudhë të shkurtër kohe tek të afërmit e mi.
 - Jam në pamundësi për gjetjen e këtyre personave sepse ka kaluar një kohë e gjatë (nga viti 2010) dhe i kam humbur lidhjet me ta.
 - Lidhur me adresën e banimit, “Rruga Bardhyl” Tiranë, e deklaruar në Deklaratën e Interesave Private Periodik/ Vjetore 2011, si vendqëndrim tjetër përveç adresës së plotë të gjendjes civile, sqarohet se:
 - Në këtë adresë kam jetuar për një periudhë të shkurtër kohe tek të afërmit e mi, përpara se të transferohem tek shtëpia e re që kam blerë në vitin 2012 në adresën: Rr. “B. Luga”, Pallati 13, shkalla 1, Apartamenti 37 Tiranë.
 - Jam në pamundësi për gjetjen e këtyre personave sepse ka kaluar një kohë e gjatë (nga viti 2011) dhe i kam humbur lidhjet me ta.

Në përfundim,

Bazuar në shpjegimet e dhëna më sipër, për secilin nga mospërputhjet ose paqartësitë e identifikuarat në raportin e Kontrollit të ILDKPKI-së, kërkojmë që Ju i nderuar Anëtar-Relator i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi:

- 1) të marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga ime si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre, të cilat në vlerësimin tim janë të plota dhe sqarojnë në mënyrë shteruese secilën nga 5 mospërputhjet ose paqartësitë e identifikuarat në gjetjet e Raportit të Kontrollit të ILDKPKI-së,
- 2) lidhur me 2 konkluzionet e paraqitura në shkronjat “a” dhe “b” të raportit të ILDKPKI-së të konstatohet se:
 - a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
 - b) është paraqitur dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e financiar të pasurive.

60. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruarat nga kandidati Dedë Kasneci në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI-së, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 16 të këtij Vendimi. Këshilli vlerësoi se, edhe pse Alpha Bank nuk i ka kthyer përgjigje Këshillit, rezultoi se kjo bankë i ka kthyer përgjigje ILDKPKI-së dhe nuk rezultoi që për këtë kandidat të ketë të dhëna financiare që ndikojnë në konkluzionet e ILDKPKI-së.

61. Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI-ja, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Dedë Kasneci. Këshilli vlerësoi edhe dokumentet e paraqitura rishtazi prej kandidatit. Por pavarësisht këtij fakti, Këshilli vlerësoi se këto nuk sillnin ndonjë ndryshim në asnjërin prej konkluzioneve të arritura prej ILDKPKI-së.

62. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Dedë Kasneci *“nuk ka kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, **ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.**

63. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d dhe nenit 125 të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Dedë Kasneci.
3. Kandidati Dedë Kasneci ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHI

